



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
DIVIZIONI JURIDIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Për: “Krijon” shpk me NIPT K12023001A**

**Adresa: Tiranë, Farkë, Rruga e Elbasanit, nr 57, Çollak, 1044.**

Procedura e prokurimit: “Procedurën e Hapur e thjeshtuar – Mallra ”

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-36173-07-13-2022.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Stacione monitorimi PM10&2.5**” 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini Nr. 98 datë 18 Korrik 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE – “KRIJON” shpk, NIPT K12023001A me vlerë 7,180,000 lekë pa tvsh.
2. OE – “ECCAT” Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing shpk, NIPT L51512009E me vlerë 6,200,000 lekë pa tvsh.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se:

Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT” Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing shpk, KVO ka evidentuar mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në Dokumentacionin e Tenderit, si vijon:

1. Operatori nuk disponon Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) ku vlera mesatare e të paktën njërit prej

tyre të jetë jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2. Operatori nuk disponon në stafin e tij një 1 (një) inxhinier elektronik/ inxhinier informatik (ose fusha të ngjashme) në stafin e vet të certifikuar/ trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës me afat gjatë gjithë kohës së garancisë, e cila të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.
3. Operatori nuk disponon autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Operatori “ECCAT” Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing shpk nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, dhe për rrjedhojë AK vendosi të **mos e kualifikoje** këtë ofertë.

2- Operatori “KRIJON” shpk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, dhe për rrjedhojë AK vendosi të **kualifikoje** këtë ofertë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**Krijon**” SHPK me NIPT **K12023001A**, dhe me adresë: Tiranë, Farkë, Rruga e Elbasanit, nr 57, Çollak, 1044, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7,180,000 (shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa t.v.sh, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Pirro Vengu**